

UNIONI SHQIPTAR KURSIM KREDI
ALBANIAN SAVINGS & CREDIT UNION



Raport Vjetor 2006





MISIONI YNË:

T'u ofrojmë shërbime financiare anëtarëve të Shoqërive Kursim Kredi në fshat, me qëllim nxitjen e aktiviteteve prodhuese, përmirësimin e nivelit të jetesës dhe zhvillimin e vazhdueshëm të zonës rurale.



FJALA E KRYETARES SE BORDIT TE DREJTOREVE



Të nderuar lexues,

Çmimi Nobel i Paqes 2006 iu dha Grammen Bank, institucion pionier i Mikrofinancës në botë, me arritje shumë të rëndësishme si financiare ashtu edhe sociale. Dhe kjo nuk ishte e rastit: në zbatim të objektivave të OKB-së për mijëvjeçarin për përhapjen dhe mbështetjen e mikrofinancës, sot është bërë e mundur që me miliona njerëz në botë, të përjashtuar nga sistemi bankar klasik, të kenë mundësi të marrin hua, të depozitojnë dhe të investojnë.

Ky vlerësim nuk kishte si të mos entuziazmonte mijërat e anëtarëve dhe stafin e Unionit SHKK, që besuan në mikrofinancën dhe ishin të parët që e implementuan atë në Shqipëri, duke pasur si objektiv themelor t'i ofrojnë popullsisë rurale shërbime financiare të nevojshme për të shumëfishuar të ardhurat e tyre dhe për të ndërtuar një të ardhme më të mirë.

Tashmë mund të themi që me Unionin SHKK, kemi ndërtuar dhe po konsolidojmë një model ekonomik të qëndrueshëm dhe jetëgjatë, i cili po mundëson ndërtimin e një sektori financiar të hapur për të gjithë banorët e zonës rurale.

Gjatë vitit 2006, Unioni realizoi me sukses objektivat e veta duke i paraprirë e përgjigjur me cilësi nevojave të 16 260 anëtarëve.

Zgjerimi i rrjetit, shtimi i numrit të anëtarëve, hartimi i produkteve të reja, përmirësimi i teknologjisë së informacionit dhe menaxhimit, administrimi i kujdesshëm i riskut, përbëjnë kolonën vertebrale të suksesit tonë.

Do të dëshiroja t'a përfundoja me një FALEMINDERIT për të gjithë aktorët e rrjetit tonë për besimin, përgjegjësinë, përkushtimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë, gjë që i mundëson të jenë realisht partnerë dinamikë dhe efikasë në zhvillimin e zonës rurale.

Ju urojmë lexim të mbarë të këtij raporti.

Zana KONINI
Kryetare e Bordit të Drejtorëve



UNIONI SHQIPTAR KURSIM KREDI

Unioni SHKK është një bashkim vullnetar i Shoqërive Kursim Kredi (SHKK) i:

- ◆ krijuar mbi bazën e Ligjit për Shoqëritë Kursim Kredi, Nr. 8782, datë 3.5.2001, më 25 Janar 2002
- ◆ regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë më 5 Shkurt 2002
- ◆ licensuar nga Banka e Shqipërisë më 27 Shkurt 2002

Shoqëritë Kursim Kredi janë bashkime vullnetare të individëve (persona fizikë ose juridikë) që kanë si qëllim mbledhjen e kursimeve dhe sigurimin e kredive për anëtarët e tyre.

Parimet e funksionimit të SHKK-ve janë:

vetë-krijimi, vetë-përgjegjësimi dhe vetë-administrimi.

FUNKSIONET E UNIONIT SHKK

- ◆ Përfaqëson rrjetin e SHKK-ve dhe koordinon aktivitetin e tyre
- ◆ Ofron trajnim dhe asistencë për SHKK-të anëtare
- ◆ Ofron shërbime të shumëllojshme financiare për SHKK-të dhe anëtarët e tyre.
- ◆ Kontrollon dhe mbikqyr aktivitetin e rrjetit SHKK, bazuar në standartet e kontabilitetit, rregullat e Bankës së Shqipërisë dhe legjislacionin respektiv.





TREGUES TË PËRGJITHSHËM TË AKTIVITETIT

SHTRIRJA GJEOGRAFIKE		
	2006	2005
Numri i Rretheve	10	8
Numri i Fshatrave	522	432
Numri i SHKK-ve	96	93
Numri i Anëtarve të SHKK-ve	16,260	12,815

EFIÇENCA DHE PRODUKTIVITETI		
	2006	2005
Klientë active / OK	504	367
Klientë active / Rreth	1,107	1,081
Portofoli i kredisë / OK	102,969,205	688,350
Numri i fshatrave / OK	23	19

PORTOFOLI I KREDISË		
	2006	2005
Numri i klientëve aktivë	11,077	8,650
Portofoli i rrjetit SHKK	2,368,291,713	1,614,869,571
Portofoli i Unionit në SHKK	1,617,053,109	1,202,201,149
Shuma e disbursuar gjatë vitit	3,404,271,381	2,392,313,590
Kredia mesatare	319,500	271,573
Rritja vjetore e portofolit të rrjetit	46,7%	32%
Portofoli në risk i Unionit	0.1%	0.50%
Portofoli në risk i rrjetit SHKK	0.5%	0.55%

KAPITALI DHE DEPOZITA		
	2006	2005
Depozita në SHKK	462,492,220	206,732,306
Numri i depozituesve	669	523
Kapitali Unionit dhe rrjetit SHKK	966,163,330	857,603,853

Shënim: Shifrat në LEKE




ARRITJET 2006

Viti 2006 është një vit i sukseshëm me arritje të dukshme në aktivitetin financiar dhe konsolidimin e mëtejshëm të institucionit, nga të cilat më të rëndësishmet janë:

RRITJA E PRANISË NË ZONËN RURALE

- rritje e numrit të anëtarëve në masën 27 %
- rritje e numrit të fshatrave në masën 20%
- zgjerimi i rrjetit në dy rrethe të reja, Librazhd dhe Sarandë



DIVERSIFIKIMI I PRODUKTEVE FINANCIARE NË PËRSHTATJE ME TREGUN


- diversifikimi i produkteve të depozitës
- hedhja në treg e kredisë SME

RRITJA E DEPOZITAVE

- rritja e depozitës në masën 123%, është rezultat i përkushtimit të Unionit për zhvillimin e mëtejshëm të SHKK-ve, forcimit të pavarësisë së tyre dhe zhvillimin e besimit reciprok në trekëndëshin Union-SHKK-anëtar.



Depozitat në rrjetin SHKK




RRITJA E AKTIVITETIT TË KREDIDHËNIES

- ritja e portofolit të rifinancimit të Unionit në masën 34.5 %
- ritja e portofolit të kredisë së rrjetit SHKK në masën 46.7%

RUAJTJA E CILËSISË SË PORTOFOLIT

- portofoli në risk për Unionin: 0.1 %
- portofoli në risk për rrjetin SHKK: 0.5 %



PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT

- ◆ përmirësimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nëpërmjet instalimit të programit KREDITS, ndërtimit të rrjeteve kompjuterike dhe përmirësimit e zhvillimit të rregulloreve dhe politikave në këtë fushë.


STRUKTURA ORGANIZATIVE

Stafi	2006	2005
Stafi Total	52	45
Oficerët e Kredisë	22	21
Ekonomistët e degëve	7	


ZONA E NDËRHYRJES

Tiranë, Elbasan, Gramsh, Durrës, Kavajë, Lushnje, Fier, Vlorë, Librazhd, Sarandë.

Nga 1026 fshatra që ndodhen në rrethet e mësipërme, Unioni SHKK aktualisht punon në 522 prej tyre.



Shënim - Në rrethet Sarandë dhe Librazhd aktiviteti filloi gjatë vitit 2006





PASQYRA FINANCIARE

BILANCI FINANCIAR I UNIONIT

2006

AKTIVI	Shuma
Likujditete	189,494,995
Portofoli neto i kredisë	1,643,061,023
Aktive fikse	15,892,011
Aktive të tjera	13,867,095
Total Aktivi	1,871,315,124

PASIVI	Shuma
Hua (linja kredie)	1,076,723,743
Depozita	31,526,347
Detyrime të tjera	94,936,308
Kapitali	668,128726
Totali Detyrime & Kapitali	1,871,315,124

BILANCI I KONSOLIDUAR I RRJETIT SHKK

2006

AKTIVI	Shuma
Likujditete	25,234,187
Investime	82,575,523
Portofoli neto i kredisë	2,379,059,105
Aktive fikse	3,683,156
Aktive të tjera	659,330
Totali Aktive	2,471,211,301

PASIVI	Shuma
Hua (linja kredie)	1,616,042,677
Depozita me afat	2,078,534,897
Detyrime të tjera	81,410,077
Kapitali	298,051,870
Total Detyrime & Kapitale	2,471,211,301

Shënim: Shifrat në LEK

PASQYRA FITIM - HUMBJE UNIONI

2006

Shuma	
Të ardhura financiare	200,842,188
Shpenzime financiare	42,768,449
Shpenzime Operacionale	134,374,661
Marzhi financiar neto	24,603,085
Të ardhura jo financiare	8,641,973
Shpenzime jo financiare	13,661,216
Rezultati	42,530,986

PASQYRA FITIM - HUMBJE E RRJETIT TE SHKK-ve

2006

Shuma	
Të ardhura financiare	279,596,102
Shpenzime financiare	180,778,244
Shpenzime Operacionale	55,838,135
Marzhi financiar neto	41,048,628
Rezultati pa subvencion	30,948,889
Rezultati	31,589,749

TREGUESIT E PERFORMANCËS DHE EFIÇENCËS

TREGUESIT E PRODUKTIVITETIT	
Huamarrës /Oficer Kredie	430
Anëtar /Oficer Kredie	651
Portofoli i kredisë / Oficer Kredie	102,969,205

TREGUESIT E EFIÇENCËS	
Kosto për huamarrës	5,241
Kosto për depozitues	83,465
Kredia mesatare outstanding	222,270
Kredia mesatare outstanding/GDP për frymë	85.7%

Shënim: Shifrat në LEK



KONTROLLI DHE MBIKQYRJA



Aktiviteti i Unionit Shqiptar Kursim Kredi mbikqyret dhe kontrollohet nga:

- ◆ **Banka e Shqipërisë**
- ◆ **Auditi i Jashtëm**
- ◆ **Auditi i Brëndshëm**
- ◆ **Komiteti Mbikqyrës i SHKK-ve dhe Unionit**

Auditimi i Jashtëm i aktivitetit të Unionit u krye nga kompania audituese ndërkombëtare KPMG gjatë Qershorit të vitit 2006. Në raportin final u konkludua se: “Pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë e të sigurtë për gjendjen financiare të Unionit SHKK më datë 31 Dhjetor 2005 dhe për rezultatet e veprimtarive të saj, në përputhje me Ligjin Shqiptar për Kontabilitetin dhe legjislacionin kontabël të zbatueshëm për Unionin Shqiptar Kursim Kredi”.

Banka e Shqipërisë, si organi me autoritetin mbikqyrës për Unionin kreu ekzaminimin e aktivitetit të tij gjatë muajit Tetor.

Në raportin e saj, theksohet: “Gjendja e përgjithëshme e Unionit Shqiptar Kursim Kredi vlerësohet “kënaqshëm”. Në vijim të konkluzioneve të ekzaminimit vlerësohet pozitivisht rritja e aktivitetit të Unionit dhe rritjet e tij të SHKK-ve.”

Kontrolli i Brëndshëm, gjatë vitit 2006 ka kryer misione në terren, të cilat kanë konsistuar në matjen e riskut operacional në SHKK, funksionimin e organeve drejtuese, zbatimin e procedurave në dhënien e kredive, etj. Gjithashtu është realizuar dhe kontrolli ekonomik e financiar në Zyrën Qëndrore të Unionit SHKK.

Komiteti Mbikqyrës i Unionit dhe ato të SHKK-ve gjatë vitit 2006 kanë ushtruar kontrole për të verifikuar zbatimin e vendimeve të Bordit të Unionit si dhe rregulloreve e procedurave të dhënies së kredisë në SHKK.



NGJARJE DHE AKTIVITETE

- Asambletë e Përgjithshme Vjetore të SHKK-ve u zhvilluan gjatë muajve Shkurt - Mars 2006. Këto Asamble analizuan aktivitetet kryesore të viti 2005, miratuan llogaritë e SHKK-ve, strategjitë dhe buxhetin për vitin 2006.
- Asambletë Rajonale u mbledhën për të përgatitur Asamblenë e Përgjithshme të Unionit SHKK dhe njëkohësisht mundësuan diskutimet për potencialet e zhvillimit dhe konsolidimit të mëtejshëm të aktivitetit të SHKK-ve.
- Asambleja e Përgjithshme e Unionit SHKK u zhvillua me 24 Prill 2006. Asambleja analizoi aktivitetin financiar dhe social të Unionit dhe rrjetit të SHKK-ve për vitin 2005, si dhe miratoi objektivat e zhvillimit për vitin 2006.

Këto aktivitete u zhvilluan në zbatim të Ligjit "Për Shoqëritë e Kursim Kreditit", si dhe statutit e rregulloreve përkatëse.





BASHKËPUNIMI TEKNIK DHE FINANCIAR ME PARTNERE TË HUAJ



Marrëveshja me “INSTITUTO DE CREDITO OFFICAL”



Marrëveshja me “Instituto de Credito Oficial”, Qeveria Spanjolle
Gjatë muajit Tetor të vitit 2006 në Tiranë dhe Madrid u nënshkrua marrëveshja për shumën e kredisë prej 5 000 000 Euro me “Instituto de Credito Oficial”, gjë që do të mundësojë zgjerimin e aktivitetit të kredidhënies në rrjet.



Rabobank

Bashkëpunimi me “RABOBANK”

Gjatë Majit të vitit 2006 u miratua projekti “Mbështetje për zhvillimin e Unionit Shqiptar Kursim Kredi”, i financuar nga Rabobank Foundation. Ky projekt synon të forcojë kapacitetin institucional të Unionit për një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatëgjatë, duke zgjeruar gamën e shërbimeve e produkteve financiare, ofruar popullsisë rurale.



Bashkëpunimi me “CREDIT MUTUEL”

Unioni SHKK ka rivendosur lidhjet me ekspertë të Bankës “Credit Mutuel”, të cilët, pas ekspertizave të tyre, ofrojnë rekomandime të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të Unionit dhe Shoqërive Kursim Kredi.

FIDES

Bashkëpunimi me FIDES

Marrëdhëniet me FIDES, i kanë fillimet e tyre në vitet 1992, dhe për vitin 2006 kanë konsistuar në mbështetje me ekspertizë në fushën e kontabilitetit.


CoopEst

Bashkëpunimi me COOPEST

Në Nëntor të vitit 2006 filluan negociatat me Coopest për realizimin e një projekti në fushën e kreditimit SME.

SFIDAT PËR VITIN 2007

- ◆ Hartimi i strategjisë për konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Unionit SHKK.
- ◆ Zgjerimi i rrjetit dhe klientelës, duke krijuar kushtet e duhura teknike dhe institucionale për një akses te gjerë në shërbimet financiare të sipërmarrësve të vegjël.
- ◆ Diversifikimi i produkteve për t'ju përgjigjur nevojave gjithmonë e në rritje të sipërmarrësve të vegjël, me qëllim përmirësimin e bizneseve të tyre në një mjedis konkurrues biznesi.
- ◆ Rritja e portofolit të kredisë dhe përmirësimi i kapaciteteve menaxhuese.
- ◆ Përmirësimi i profilit institucional drejt një banke mikrofinanciare rurale, duke u mbështetur në ndihmën e investitorëve privatë apo institucionalë, të cilët ofrojnë mbështetje afatgjatë dhe ekspertizë bankare.





KLIENTET TANE



FATOSH DANAJ

Fatosh Danaj është jo vetëm një ekonomist i mesëm, por edhe kryetari i SHKK-së së fshatit të ngrohtë të Llakatundit. Pas një udhëtimi në Francë, të organizuar nga Unioni SHKK, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës me bankën “Credit Mutuel”, Z. Danaj vendosi të ndërtojë një vreshtari me kualitet të mirë, si ato që pa në Francë.

“Nuk mund t’i plotësoja asnjëherë vetë paratë për ngritjen e një vreshtarie me kualitet të mirë, prandaj vendosa të merrja kredinë e parë në SHKK-në tonë. Pasi krijova vreshtin, mora një kredi të dytë, e cila më ndihmoi për blerjen e fidaneve dhe kredia e tretë për zgjerimin e aktivitetit tim. Kreditë e marra nga SHKK-ja më ndihmuan shumë në zgjerimin dhe përmirësimin e biznesit. Vetëm vitin që sapo kaloi pata 1.000.000 lekë fitime!”

Z. Danaj është shumë i kënaqur me mbështetjen që SHKK-ja i ka dhënë atij dhe 220 klientëve të SHKK-së së Llakatundit. Ai mendon se me ndihmën e kredive të marra në SHKK, në fshatin e tij po zgjerohen bizneset ekzistuese dhe po krijohen biznese të reja, duke ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e jetesës së banorëve. Ai mendon se së shpejti Llakatundi do të kthehet në një qytezë të vogël, me nevoja më të mëdha për kredi dhe për produkte të tjera financiare, të ofruara nga rrjeti SHKK.

Fshati Radë është një fshat i vjetër, i mirëorganizuar dhe me një traditë të pasur. Banorët e tij nuk synojnë qytetin, si shumë banorë të zonës rurale, por shtëpitë e tyre të reja dhe aktivitetet private ata preferojnë t’i ndërtojnë në këtë fshat. Edhe Hysni Gjergji është një nga banorët e Radës, që nuk ka dashur t’a lërë asnjëherë fshatin, por ka ndërtuar atje aktivitetin e tij.

Kredinë e parë e mori në vitin 2002, për të mbështetur aktivitetin në një baxho qumështi, të cilën Hysniu vendosi më vonë t’a mbyllë për tu përqëndruar në 3 bizneset e tij aktuale. Kredinë e dytë e mori për të investuar në sera, të cilat nga dy dynym i zgjeroi në katër dynym tokë dhe nga ku nxjerr një fitim prej 2 milion lekësh vetëm gjatë një sezoni. Hysniu dhe familja e tij, veç serave, sot drejtojnë një minikantinë vere, dhe një dyqan.


Hysniu është një nga klientët më të suksesëshëm të rrjetit SHKK dhe, në të njëjtën kohë, është edhe kryetar i SHKK-së Radë.

“Kreditë SHKK-së kanë qënë një mbështetje bujare dhe e sigurtë si për biznesin tim ashtu edhe për atë të gjithë klientëve të SHKK-së Radë. SHKK-ja ka financuar mjaft biznese të vogla dhe të mesme të zonës, duke fituar besueshmërinë e anëtarëve dhe rritjen e përditëshme të kërkesave për kredi.”

HYSNI GJERGJI



STRUKTURA ORGANIZATIVE E UN ORGANIZATIONAL CHART OF ALBAN





UNIONIT SHQIPTAR KURSIM KREDI ALBANIAN SAVINGS AND CREDIT UNION

